



INSTITUTI I HISTORISË
DHE
FONDACIONI “KONRAD ADENAUER”

Organizojnë

Konferencën shkencore

më temën:

QASJE MBI HISTORINË E SHQIPËRISË TË VITEVE 1945-1990

E enjte, 9 qershor 2022
Antigonea 2, Hotel Rogner, Tiranë

Karakterit dhe qëllimi i konferencës. Konferenca synon të trajtojë tezat, metodologjinë, problematikat dhe sfidat që lidhen me trajtimin historik të periudhës 1945-1990. Gjatë viteve të tranzicionit janë botuar një numër i madh librash, studimesh, vëllime dokumentare etj, si dhe janë zhvilluar konferenca, tryeza dhe debate publike, të cilat së bashku përbëjnë një bazë të pasur referimi për një vlerësim më profesional lidhur me Shqipërinë e periudhës totalitare.

Konferenca synon të krijojë një mjedis profesional debati midis ekspertëve të fushës së studimeve historike, të sjellë risi dhe këndvështrime të reja në vlerësimin historik mbi të kaluarën, si dhe të kontribuojë në trajtimin më të thelluar shkencor të kësaj problematike, si dhe sfidave të ardhshme.

Referimet në konferencë do të jenë pjesë e një botimi të posaçëm realizuar nga Instituti i Historisë dhe KAS.

Tezat e mundshme për diskutim:

- Historia politike 1945-1990 dhe aspektet ekonomike e sociale;
- Sistemi qeverisës dhe ndikimi në funksionimin shtetëror;
- Roli i PPSH-së në funksionimin e institucioneve dhe sistemit qeverisës;
- Roli i ideologjisë në vendimmarrjet shtetërore dhe formësimin e shoqërisë;
- Koncepti i centralizmit dhe planifikimit në shtet dhe në ekonomi
- Roli i kultit të individit dhe drejtimit të personalizuar në formësimin e kulturës politike dhe shoqërisë shqiptare;
- Sistemi i dhunës politike dhe të drejtat e njeriut
- Raportet midis qytetarit dhe shtetit;
- Shqipëria dhe vendi i saj në botën komuniste
- Shqipëria dhe Lufta e Ftohtë, të përbashkëta dhe veçori
- Shqipëria 1945-1990 dhe raporti me shtetet e tjera
- Trashëgimia në kulturën politike, përfaqësimin dhe vendimmarrjet
- Tiparet e shkrimit të historisë mbi periudhën 1945-1990;
- Sfidat e rishkrimit të historisë mbi periudhën 1945-1990;
- Shqipëria 1945-1990 në tekstet shkollore;
- Shqipëria 1945-1990 në botimet historike shqiptare;
- Shqipëria 1945-1990 në botimet historike të huaja.

Përshkrimi i aktiviteteve

Konferenca është një ditore. Krahas pjesën formale, konferenca do të vijojë me prezantimin e punimeve referuese nga studiuesit. Midis referimeve do të ketë kohë në dispozicion për ndërhyrje dhe diskutime. Pas konferencës referimet do të editohen dhe botohen nga Instituti i Historisë.

Pjesëmarrësit në Konferencë

Janë të ftuar kryesisht studiues të historisë nga institucionet kërkimore në fushën historike në Tiranë dhe institucionet universitare, si dhe ekspertë të fushës nga vende të tjera, shqiptarë apo të huaj që kanë Shqipërinë në fokus të punës së tyre kërkime. Në varësi nga interesi i shprehur dhe pranimi i propozimeve mund të krijohet hapësira e aksesit online për referues që e kanë të pamundur të jenë prezent. Punimet e konferencës do të jenë me përkthim dy gjuhësh, shqip dhe anglisht. Të gjithë referuesit e përzgjedhur do të ketë honorar nga organizatorët. Bazuar në buxhetin në dispozicion numri i referuesve do të jetë i kufizuar në 13-15 prezantime.

Kriteret e përgatitjes dhe paraqitjes së kumtesës

Secili pjesëmarrës do të ketë në dispozicion 10 minuta kohë për paraqitjen e tezave dhe gjetjeve kryesore. Kumtesat për konferencë duhet të jenë përafërsisht 4 faqe, ndërsa versioni final i punimit për botim rekomandohet nga 15-20 faqe. Të gjitha punimet duhet të jenë origjinale dhe në përputhje me standardet e etikës akademike. Punimet për botim pranohen në gjuhën shqip ose anglisht (në çdo rast abstrakti dhe një përmbledhje në fund duhet të jetë në anglisht). Punimet përfundimtare duhen dërguar në adresën elektronike: ih@asa.edu.al.

Informacionet e nevojshme për formatimin e punimit

Artikulli duhet të shkruhet në fletë standarde A4 me hapësirë 1" në të gjitha anët, me font 12 *Times New Roman* dhe hapësirë 1.5. Artikulli duhet të përmbajë: Titullin, Abstraktin (150-300 fjalë), Zhvillimin dhe Referencat. Pas titullit duhet të vendosen informacionet në lidhje me autorin (Emër, Mbiemër, Institucioni ku punon). Stili i referencave: *Chicago Style*.

Punimet në versionin përfundimtar do t'i nënshtrohen një vlerësimi nga stafi editues dhe do të botohen nga Instituti i Historisë në bashkëpunim me KAS. Botimi do të jetë në print dhe i pajisur me ISBN.

Afate të rëndësishme

- Afati i fundit për dorëzimin elektronik të abstrakteve: *15 maj 2022*
- Njoftimi i pranimi të punimit: *20 maj 2022*
- Dorëzimi i punimet përfundimtare: *30 shtator 2022*